



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AKADEMIA E SHKENCAVE
KANCELARI

Nr. 721 prot.

Tiranë, më 27.04 2026

Lënda: Mbi gjendjen e ndërtesës ku ushtron veprimtarinë e saj Akademia e Shkencave.

BASHKËPRONARËVE
Sipas certifikatës së pronësisë

Për dijeni: MINISTRISË SË TURIZMIT, KULTURËS DHE SPORTIT
Rruga “Aleksandër Moisiu”, NR. 36,
Ish – Kinostudio “Shqipëria e Re”, Tiranë

Të nderuar bashkëpronarë,

Pas tërmetit të nëntorit ndërtesa me status “Monument Kulture i kategorisë së I-rë” (Urdhri i ministrit të Kulturës, nr. 67, datë 17.3.2016 “Për shpallje monument kulture i kategorisë së I-rë për objektin “Akademia e Shkencave”), është klasifikuar ndërtesë me shkallë të dëmtimit D3 (dëmtime të mëdha por jo për prishje ku duhen riparime të domosdoshme; bashkëngjitur). Sa më sipër, duke patur parasysh se ASHSH ka nënshkruar kontrata qeraje me ju dhe prej të paktën 20 vitesh nga ana juaj nuk janë bërë ndërhyrje apo restaurime në objekt, nevojitet kryerja e riparimeve të menjëhershme e të domosdoshme në objekt.

Sa më sipër:

Ju bëjmë me dije detyrimet tuaja, referuar neneve 8 dhe 10 të kontratës së qirasë dhe ligjit nr. 27/2018 “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, i ndryshuar, për të realizuar ndërhyrjet e domosdoshme në bashkëpunim me Institutin Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore dhe Materiale, në mënyrë që ndërtesa të garantojë siguri fizike dhe funksionalitet të saj dhe të dalë nga kategoria/klasifikimi D3. Në raportin e Ministrisë së Kulturës për vlerësimin e dëmtimit në objekte të trashëgimisë kulturore dhe raportit të inspektimit nga specialistët e IMK-së (bashkëngjitur), ndërtesa klasifikohet si përkohësisht të përdorshme dhe se godina nuk duhet të përdoret në mënyrë të vazhdueshme

Në projekt raportin e hartuar nga Ministria e Kulturës parashikohet një vlerë prej 20,958,274 Lekë për restaurimin dhe riparimin e dëmeve të shkaktuara (bashkëngjitur). Në mbështetje të

vendimit nr. 198, datë 26.7.2017 të KKTKM-së dhe indeksit të çmimeve nga viti 2017 në vitin 2026 (mesatarja 40%), mbështetur në të dhënat nga INSTAT, vlera totale sipas preventivit për shpenzimet për rikonstruksionin e ndërtesës së Akademisë së Shkencave është në shumën 29,341,583 Lekë.

Bashkëngjitur kësaj shkrese gjeni Formularin për vlerësimin e dëmtimit në objekte të trashëgimisë kulturore nga Instituti i Monumenteve të Kulturës dhe raportin e inspektimit nga Ministria e Kulturës, të cilat i gjeni dhe në faqen web të Akademisë së Shkencave www.akad.gov.al.

Faleminderit për bashkëpunimin.

KANCELAR

Ruzhdi Kuçi





**MONUMENTE
DHE SITE TË
TRASHËGIMISË
KULTURORE**

Akademia e Shkencave, Tiranë (II-044)



	Vendim KTKM	Projektim, Mbikëqyrje, Kolaudim (në Lekë)	Zbatim (në Lekë)
Projekt "Restaurimi i gatisë së ndërtesës "Akademia e Shkencave", hartuar nga DRKK Durrës.	Nr. 198, dt 26.07.2017	445,529	3,712,745
Projekti i rikontraksionit të "Akademise së Shkencave"		1,800,000	15,000,000
Total		2,245,529	18,712,745





FORMULAR

PËR VLERËSIMIN E DËMTIMIT NË OBJEKTE TË TRASHËGIMISË KULTURORE

Relacioni Nr.	01	Data e Inspektimit:	05/12/2019	Ora:	14:00
Nr. i inspektimit:	01	Inspektori /ët:	Ing.Zaim Lila Ark. Katerina Margariti	Institucioni:	IMK

1. PËRSHKRIM I PËRGJITHSHËM

1.1 EMËRTIMI: AKADEMIA E SHKENCAVE

1.2. KODI II-045

1.3 STATUSI / SHPALLJA Monument Kulture Kategoria e I-Rë - Urdhër nr. 67, datë 17.03.2016, Ministria e Kulturës.

1.4. ADRESA: Rrethi Tiranë, Qyteti Tiranë, "Murat Toptani", pranë Parlamentit të Shqipërisë.

1.5. PRONARI / PËRDORUESI: Shtetërore

1.6. PIKË KONTAKTI:

PIKË KONTAKTI: Ndërtesë e Projektuar
 Objekt Kulturi
 Tjetër

1.8 LLOJI I KONSTRUKSIONIT: Beton arme Muraturë me soleta Miqs - specifiko
 Muraturë tulle Muraturë guri Tjetër - specifiko

1.9. NR. I KATEVE / PËRMASAT
Nr. i kateve mbi tokë: 2
Nr. i kateve nën tokë: 1\2

1.10. VITI I NDËRTIMIT Fillim shek 20 Regjimi Komunist E panjohur

2. VLERËSIMI I DËMTIMIT

	<input checked="" type="checkbox"/> Dëmtime sipërfaqësore në suva (specifiko spesorin e çarjeve dhe ambjentit)
	<input checked="" type="checkbox"/> Dëmtim i lehtë i elementëve strukturorë (çarje deri 2 mm)
	<input checked="" type="checkbox"/> Dëmtim mesatar i elementëve strukturorë (çarje të dukshme)
	<input checked="" type="checkbox"/> Dëmtim i strukturës së mbulimit\cati E përdorshme (pa rrezik)
2.3. KLASIFIKIMI I PËRGJITHSHËM	<input checked="" type="checkbox"/> Përkohësisht e përdorshme Godina nuk duhet të përdoret në mënyrë të vazhdueshme deri sa të bëhet një vlerësim më i detajuar dhe të merren masat e sigurisë të propozuara.
	<input type="checkbox"/> Godinë e rrezikuar (e papërdorshme) Godina paraqet rrezik për dëmtime të mëtejshme / rrëzim / shkatërrim. Ndalohej hyrja. Duhet të merren masa emergjente për vendosjen në siguri të strukturave. Duhet ndërmarrë vlerësim më i detajuar – analizë strukturorë.
2.4. Vlerësimi i aplikueshëm për	<input type="checkbox"/> Të gjithë godinën
	<input type="checkbox"/> Pjesërisht (specifiko ambjentet)
	<input checked="" type="checkbox"/> - Të gjithë objektin përveç catisë.

3. MASAT E NEVOJSHME

3.1. MASA EMERGJENTE TË PROPOZUARA	<input type="checkbox"/> Perimetër sigurie (shirit dhe tabela ndaluese për hyrje në:
	<input type="checkbox"/> Pajantim / Puntelim i elementëve / ambjenteve si më poshtë:
	<input checked="" type="checkbox"/> Çmontim i elementëve si më poshtë (për parandalimin e rrezikut të rënies): - Heqja e dekoracioneve të alicisë.
	<input checked="" type="checkbox"/> Vlerësim i detajuar strukturor i elementëve si më poshtë: Kontroll i imtësishëm i strukturës së catisë, tavaneve pre jpekallami, i ndërkateve me strukturë druri.
	<ul style="list-style-type: none">• Kontroll i imtësishëm i strukturave të catisë.• Kontroll i imtësishëm i tavaneve me peskallami.• Heqja e dekoracioneve të alicisë ne tavan në të gjitha ambjentet ku përbejnë rrezik.• Kontroll i ndërkateve me strukturë druri.• Verifikim i materialit përberës të pllakave dekoruese në tavanin e hollit të katit të parë (nëse janë prej allice propozohet heqja).

Ing.Zaim Lila

Ark.Katerina Margariti

RAPORT INSPEKTIMI
OBJEKTI: AKADEMIJA E SHKENCAVE

EMËRTIMI AKADEMIJA E SHKENCAVE (II-045)


ADRESA (Rrethi, qyteti, fshati, lagja, rruga, numri)

Rrethi Tiranë, Qyteti Tiranë, Shëtitörja Murat Toptani, Tiranë 1000

SHPALLJA MONUMENT

Urdhër nr. 67, datë 17.03.2016, Ministria e Kulturës, Kategoria I

VENDNDODHJA



GJENDJA E MONUMENTIT

Në kuadër të inspektimit të objekteve me status monument kulture, pas rënies së tërmetit të datës 26.11.2019 u krye verifikimi në vend i objektit “Akademia e Shkencave”. Inspektimi paraprak u krye më datë 05.12.2019 dhe u konstatuan sa më poshtë:

- Rëzimi i kornizave dekorative te allcisë në tavan në ambjentet e zyrave;
- Carje në kolonë dhe tra në krahun Perëndimor (zyra e Kryetarit të Akademisë);
- Carje në muret anësore në krahun Lindor (zyra e Shkencave të Natyrës);
- Si pasojë e kubaturës së lartë (4m) ka plasaritje të mureve ndarëse;
- Plasaritje e lehtë në njerin nga muret e podrumit të godinës;





MASAT EMERGJENTE



Propozojmë të ndërmerren këto masa paraprake:

- Kontroll i imtësishem i strukturave të catisë.
 - Kontroll i imtësishëm i tavaneve me peskallami.
 - Heqja e dekoracioneve të allcisë ne tavan në të gjitha ambjentet ku perbejnë rrezik.
 - Kontroll i ndërkateve me strukturë druri.
 - Verifikim i materialit përberës të pllakave dekoruese në tavanin e hollit të katit të parë (nëse janë prej allcie propozohet heqja).
-


FOTO GJATË INSPEKTIMIT




Plasaritje e mureve ndarëse si pasojë e lartesisë




Carje në kolonë dhe tra në krahun Perëndimor (zyra e Kryetarit të Akademisë)




Rëzim i kornizave dekorative të alloisë.



Carje në muret anësore në krahun Lindor (zyra e Shkencave të Natyrës)



Plasarije e lehtë në njërin nga muret e podrumit të godinës



Carje në tavënin me peskallimi

Përgatiti Relacionin:

Ing. Zaim Lila

Ark.Katerina Margariti

Katerina Margariti